



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1031 Prot

Elbasan, më 31.1.2023

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.1, datë 24.01.2023 "Mbi kriteret e pëdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.





**VENDIM**

**Dt.25.01.2023**

Nr. 459 prot

**Nr.1 dt.24.01.2023**

**Mbi kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar për Bllok Ndhimën  
Ekonomike deri në 6%**

Mbështetur në ligjin 139/2015 për "Vetqeverisjen Vendore", Ligji 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me Ligjin nr 137/2020, bazuar në nenin 21 të ligjit 57 datë 18.07.2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", ku citohet shprehimisht: **Këshilli bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror, si dhe bazuar në VKM 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike"** Me propozim të strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale, Këshilli bashkiak në mbledhjen e tij të datës 24.01.2023 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kriterëve specifike për familjet që do të përfitojnë Ndhimë Ekonomike me 6% e fondeve të kushtëzuara të Bllok-Ndhimës për vitin 2023.

Përfshihen në skemën e 6% familjet të cilat janë shpallur me pikë të pamjaftueshme nga sistemi NE dhe mbartin problematikat e mëposhtme social-ekonomike.

- Te jene familje me kryefamiljare Gra
- Te jene familje qe kane ne perbrjen e tyre Persona me Aftesi te kufizuara apo Invalide Pune
- Te jene familje ekstremisht te varfëra qofte edhe kur kane nje automjet te regjistruar por nuk e kane ne perdorim dhe nuk e kane cregjistruar ne Drejtorine Rajonale te automjeteve per arsye ekonomike.
- Te jene familje me shume antare sidomos me femije nen moshen 18-vjec
- Te jene familje me femije jetim ose ne kujdestari te ketyre femijeve
- Te jene familje me probleme te ndryshme Sociale
- Familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë mbi moshë pune.
  
- Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë që ndjekin Universitetin (Arsimin e lartë publik
  
- Familje qe kane pesuar fatkeqsi natyrore.

2.Per familjet qe do te trajtohen me ndihme ekonomike duhet te jete kryer paraprakisht vlersimi social ekonomik ne familje nga administrator shoqeror sipas formularit tip te verifikimit dhe qe ruhet ne dosjen e dekumentave te aplikantit prane njesise vendore dhe qe i bashkengjitet Pr/Vendimit te ardhur nga Njesite Administrative.

3.Ndjek zbatimin e ketij vendimi Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Menaxhimit Financiar,Spektori i Ndhmes Ekonomike dhe Sherbimeve Sociale.

4.Ky vendim hyne ne fuqi 10 dite pas shpalljes se tij.

**Sek.i Keshillit**  
**Elson Malluta**



**KRYETARI I KESHILLIT**  
**Shefki Bahiti**

